

UDHËZIM
Nr. 20, datë 17.11.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 27.12.2011
“PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 6, germa “e” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 54 riformulohet: “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.”.

2. Në pikën 64 shtohet një paragraf si më poshtë:

“Përfshirë bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor.”.

3. Në pikën 73 fjalia e fundit ndryshohet me këtë përmbajtje “Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.”.

4. Pika 85/c riformulohet: “Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

5. Në pikën 90/c togfjalëshi “ose vlerës së drejtë por jo më të vogël se vlera neto kontabël”, zëvendësohet me togfjalëshin “ose vlerës së drejtë por jo më pak se 50% të çmimit të blerjes ose të vlerës bruto”.

6. Pika 96 riformulohet: “Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsim apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Komisioni i vlerësimit ngrihet me miratim të titullarit. nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.

Për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të organizuara me disa nivele vartësie të njërive shpenzuese, komisioni i vlerësimit ngrihet nga nëpunësi autorizues i nivelit të dytë në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Nëpunësi autorizues i nivelit të dytë ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit në njësitë e vartësisë së tij, i cili raporton tek nëpunësi autorizues i njësisë publike”.

7. Pika 100 riformulohet: “Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në varësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani